

UNMIK/REG/2008/24
16 maj 2008

RREGULLORE NR. 2008/24

**PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI MBROJTJEN E VARIETETEVE TË
BIMËVE TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës, të datës 13 shkurt 2007, lidhur me Ligjin mbi mbrojtjen e varieteteve të bimëve, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 26 janar 2007,

Duke ditur se dispozitat e Ligjit nuk e cenojnë autorizimin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas RKSKB 1244 (1999) apo kompetencat e tij të rezervuara dhe përgjegjësitë sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall Ligjin mbi mbrojtjen e varieteteve të bimëve, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 02/L-98) që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje dhe i cili bëhet i plotfuqishëm në datën e nënshkrimit.

Nënshkruar sot, më 16 maj 2008.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm